



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:200624
Datë: 23.12.2024
Numri i dokumentit: 06640000

Pml.nr.746/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Valdete Daka, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit J. K., nga P.a, për shkak të veprave penale: “Kanosja”, nga neni 181, paragrafi 4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe “Mospërfillja e gjykatës”, nga neni 393, paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1586/2024, datë 14.08.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1620/2024, datë 29.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin si të bazuar të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit J. K., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1586/2024, datë 14.08.2024 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1620/2024, datë 29.10.2024, ashtu që kjo çështje penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1586/2024, datë 14.08.2024, i dënuari J. K., është shpall fajtor për shkak të veprave penale: “Kanosja”, nga neni 181, paragrafi 4 të KPRK (pika I.) dhe “Mospërfillja e gjykatës”, nga neni 393, paragrafi 1 të KPRK-së (pika II.).

Pas këtyre, dispozitivi i aktgjykimit të kësaj gjykate (në mënyrë të njëjtë është përshkruar edhe dispozitivi i aktgjykimit të shpallur) përmban edhe një tekst të shkruar nga dy (2) pasuesë, në të cilat janë konstatuar dhe paraqitur disa të dhëna në lidhje me disa deklaratata dhe prova tjera, mbi bazën e të cilave është theksuar rreziku i përsëritjes së veprës penale, si dhe janë paraqitur të gjitha aktgjykimet, shumë prej tyre edhe me dënime të shlyera, të cilat janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimit.

Mandej, për veprën penale nga pika I. e dispozitivit ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e tre (3) muaj, kurse për veprën penale nga pika II. e dispozitivit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muajve, për t'i shqiptuar në vijim dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e tre (3) muajve, në të cilin dënim, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga 14.07.2024, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Është detyruar i dënuari J. K., që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumë prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Palët e dëmtuara – Z. A. dhe L. A., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Janë konfiskuar fishekët e sekuestruar, konform nenit 269 të KPRK-së, me vërtetimin për sekuestrimin me numër 2024-AC-0960.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1620/2024, datë 29.10.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit J. K., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit, avokati Shkelzen Behrami, ku nga përmbajtja e të njëjtës, rezulton se është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që këto aktgjykime të anulohen, ndërsa kjo çështje penale t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.426/2024, datë 09.12.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit Jeton Kurda, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, që ndërlidhen me pranimin e fajësisë, dorëzimit të provave dhe aktakuzës, si dhe arsyetimin dhe vlerësimin e rrethanave që janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimit.

Në këtë drejtim, mbrojtësi pretendon se nuk janë përmbushur të gjitha kriteret ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë, në veçanti kriteri i përcaktuar në dispozitën ligjore të nenit 242, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3. të KPP-së, në të cilën dispozitë ligjore është përcaktuar se “pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i akuzuari dhe çdo provë tjetër siç është dëshmia e dëshmitarit e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i akuzuari”, duke konsideruar se gjyqtari i vetëm gjykues është dashur që të veprojë sipas dispozitës ligjore të nenit 242, paragrafi 4 të KPP-së, duke nxjerrë aktvendim për refuzimin e pranimit të fajësisë.

Gjithashtu, mbrojtësi pretendon se i dënuari nuk është njoftuar me asnjë provë të vetme materiale, madje as me aktakuzën, të cilat aspekte kanë ndikuar që i dënuari të mos e ketë patur mundësi për ta kuptuar natyrën e veprave penale për të cilat është akuzuar dhe pasojat e pranimit të fajësisë, aq më parë kur aktakuza është ngritur dy (2) ditë para mbajtjes së shqyrtimit fillestar. Përveç këtyre, e kundërshtohen edhe cilësimin juridik i veprës penale sipas pikës I. të dispozitivit të aktgjykimimit, si dhe rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimeve.

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të dënuarit J. K., Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 3, 4, 6 dhe 8 dhe nenin 239; nenin 240, paragrafët 3 dhe 5; nenin 241, paragrafi 2 dhe nenin 242, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3. të KPP-së, të cilat shkelje kanë ndikuar në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e këtyre aktgjykimeve.

Siç është theksuar edhe më parë, i dënuari J. K., është shpallur fajtor për shkak të veprave penale: “Kanosja”, nga neni 181, paragrafi 4 të KPRK dhe “Mospërfillja e gjykatës”, nga neni 393, paragrafi 1 të KPRK-së dhe ndaj tij, për shkak të kryerjes së këtyre veprave penale janë shqiptuar dënimet veç e veç, ndërsa më pastaj edhe dënimi unik me burgim në kohëzgjatjen e përcaktuar më lart.

Mirëpo, në dispozitivin e aktgjykimimit të gjykatës së shkallës së parë, në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 369, paragrafët 3 dhe 4 të KPP-së janë paraqitur edhe shumë të dhëna tjera të panevojshme, në lidhje me disa deklaratatë të dëmtuarve, të dënuarit dhe prova tjera, mbi bazën e të cilave është theksuar rreziku i përsëritjes së veprës penale, si dhe janë paraqitur të gjitha aktgjykimet, shumë prej tyre edhe me dënime të shlyera, të cilat janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimit. Në mënyrë të njëjtë, është vepruar edhe me aktgjykimin e shpallur, andaj edhe si e tillë, kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimimit të gjykatës

së shkallës së parë përmban të dhëna të panevojshme, në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore, të cilat më pastaj, bëjnë që ky aktgjykim në këtë pjesë të jetë i paqartë dhe kundërthënës.

Gjithashtu, siç me të drejtë pretendon edhe mbrojtësi i të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktvendimi për miratimin e pranimin të fajësisë është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 242, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3. lidhur me nenin 239; nenin 240, paragrafi 5 dhe nenin 241, paragrafi 2 të KPP-së, pasi që nuk rezulton se të dënuarit t'i jenë dorëzuar provat mbi bazën e të cilave është bazuar aktakuza, siç nuk rezulton që të njëjtit t'i jetë dorëzuar as një kopje e aktakuzës para mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në mënyrë që i njëjti të ketë kohë të mjaftueshme për ta përgatitur në mënyrën e duhur mbrojtjen e tij. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme e Kosovës, ka parasysh edhe zgjidhjen ligjore që ka ofruar dispozita ligjore e nenit 240, paragrafi 3 të KPP-së, që aktakuza të pandehurit t'i dorëzohet gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, mirëpo një gjë e tillë do të duhej të vinte në shprehje, vetëm nëse i pandehuri nuk e ka pranuar kopjen e aktakuzës për përkundër përpjekjeve të arsyeshme të prokurorit të shtetit për të bërë dorëzimin. Nga shkresat e lëndës, nuk del që të jetë bërë ndonjë “përpjekje e arsyeshme e prokurorit të shtetit për të bërë dorëzimin e aktakuzës”, andaj edhe gjykata e shkallës së parë nuk është dashur që të mjaftohet me dorëzimin e aktakuzës gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, për shkak se një veprim i tillë do të minonte dhe cenonte të drejtat e mbrojtjes, duke qenë se të pandehurit nuk i ipet kohë e mjaftueshme për ta përgatitur mbrojtjen. Në këtë kontekst, nga shkresat e lëndës, shihet se aktakuza është ngritur më 12.08.2024, ndërsa shqyrtimi fillestar është mbajtur pas dy (2) dite, përkatësisht më 14.08.2024, i cili ka filluar në ora 10:00 minuta dhe ka përfunduar në ora 10:35 minuta.

Në këtë drejtim, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se e drejta e të pandehurit/akuzuarit që të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet, përveç me dispozita ligjore, është ngritur edhe në rang të parimeve kushtetuese (neni 30(3) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës) dhe është pjesë përbërëse e “E drejtës për një proces të rregullt”, sipas nenit 6, paragrafi 3/b të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe është promovuar vazhdimisht edhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Përveç këtyre, është e rëndësishme që të sqarohet se bazuar në dispozitën ligjore të nenit 369, paragrafët 6 dhe 8 të KPP-së, gjykatat duhet që “në arsyetimin e aktgjykimit të paraqesin arsyet për çdo pikë të aktgjykimit”, ndërsa në rastet kur i pandehuri/akuzuari dënohet me burgim, atëherë “arsyetimi duhet të përfshin edhe rrethanat të cilat gjykata i kanë marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit”, të cilat rrethana duhet të gjejnë mbështetje në dispozitat përkatëse ligjore dhe të mos jenë në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës penale. Gjithashtu, është e rëndësishme që të theksohet se me rastin e matjes së dënimit, gjykatat duhet pasur në konsideratë edhe dispozitën ligjore të nenit 3, paragrafi 1 të KPP-së, ku është parashikuar se “Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për veprë penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës”.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar duke u bazuar në këto dispozita ligjore, pasi që pjesën e arsytimit nuk janë paraqitur arsye të qarta dhe të kuptueshme se pse janë vlerësuar si rrethana rënduese disa rrethana që nuk është dashur të trajtohen si të tilla, e që rrjedhimisht kjo pjesë e arsytimit është kundërtë.

Kështu, në pjesën e arsytimit të aktgjykimit të lartcekur shihet që gjykata e shkallës së parë e ka marrë për bazë si rrethanë rënduese edhe dënimet e shqiptuara më parë, për të cilat ka konstatuar se janë shlyer.

Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se dënimi i shqiptuar me aktgjykim të formës së prerë i cili është shlyer nga evidenca e personave të dënuar, nuk mund të merret për bazë si rrethanë rënduese me rastin e matjes së dënimit, siç ka vepruar gjykata e shkallës së parë. Kjo për faktin se bazuar në dispozitën ligjore të nenit 94, paragrafi 3 të KPRK-së “kur dënimi shlyhet, atëherë pushojnë pasojat juridike të dënimit”. Gjithashtu, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 96, paragrafi 1 dhe nenit 97 të KPRK-së, “në momentin kur shlyhet dënimi nga evidenca e personit të dënuar (“Rehabilitimi ligjor ose gjyqësor”), personi i tillë nuk konsiderohet i dënuar, përkatësisht konsiderohet i padënuar”.

Po ashtu, nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë shihet që me rastin e caktimit të dënimit është marrë për bazë si rrethanë rënduese fakti se i dënuari është “i dyshuar edhe për 44 vepra penale të natyrave të ndryshme”. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë është dashur që të jetë më e qartë në lidhje me të kaluarën e të dënuarit J. K., dhe se nuk është dashur që të marrë parasysht faktin se i dënuari është i dyshuar edhe për disa raste të tjera, pasi që një gjë e tillë do të ishte në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, i cili parim, përveç me dispozita ligjore, është i garantuar edhe me nenin 31, paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6, paragrafi 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se vetëm aktgjykimet e formës së prerë me të cilat është shpallur fajtor i dënuari, nën rrethana të caktuara dhe nën supozimin e përmbushjes së kushteve të caktuara, mund të merren për bazë si rrethana rënduese me rastin e matjes së dënimit, por nuk duhet të merret në konsideratë fakti se i dënuari paska qenë i dyshuar për disa vepra penale, pasi që kjo nuk do të thotë se i njëjti edhe është fajtor për këto vepra penale.

Në lidhje me këtë çështje, është e rëndësishme që të theksohet se edhe në dispozitën ligjore të nenit 70, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.13. të KPRK-së është parashikuar se “Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysht, por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese: - ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar”, ndërsa në dispozitën ligjore të nenit 19, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6. të KPP-së është parashikuar se “Person i dënuar konsiderohet personi i cili me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale”.

Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të rëndësishme të rikujton se në dispozitën ligjore të nenit 9, paragrafi 4 të KPRK-së është parashikuar se “Kur cakton dënimin për recidivistin, gjykata posaçërisht merr parasysh nëse kryesi më parë ka kryer veprë penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur ose i falur”.

Andaj, në këtë mënyrë, duke u bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, kjo pjesë të arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është e paqartë dhe nuk është në harmoni me dispozitat ligjore të paraqitura më lart.

Në këtë mënyrë, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovoi si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të anuloi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara më lart, me të cilat është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e të cilat nuk janë evituar as me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur të tejkalohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, pasi që këto shkelje kanë ndikuar në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e këtyre aktgjykimeve.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktojë edhe një herë shqyrtimin fillestar dhe t'i evitojë të gjitha shkeljet e lartcekura, duke marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm për çdo pikë të aktgjykimit, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.746/2024, më 19.12.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi